

**STATUT
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“DN PROJECTS” SH.P.K**

Në Tiranë, sot më **24.05.2021** (dymijë e njëzet e një):

z.Dritan Ndoj, shtetas shqiptar lindur më 22-04-1980, në Pukë dhe banues në Tiranë, madhor dhe me zotësi të plotë për të vepruar mbajtës i letërnjoftimit (ID) me Nr.032754871 dhe Nr.Personal I00422060L;

Në cilësinë e ortakut të vetëm të shoqërisë “DN PROJECTS” SH.P.K, vendosë të përpilojë, miratojë dhe nënshkruajë Statutin në përputhje me kushtet si vijojnë:

**KREU I
EMËRTIMI I SHOQËRISË – SELIA – KOHËZGJATJA**

NENI 1 - FORMA JURIDIKE

- 1.1 Shoqëria e quajtur “DN Projects” sh.p.k, (referuar ndryshe si “Shoqëria”), është formuar si shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, me ortak të vetëm.
- 1.2 Shoqëria do të veprojë në përputhje me këtë Statut, dispozitat e Ligjit Nr.9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë Tregtare”, të ndryshuar dhe legjislacionit shqiptar në fuqi.

NENI 2 – SELIA ADMINISTRATIVE

- 2.2 1. Selia administrative e shoqërisë ndodhet në adresën: **Rr.Ibrahim Rugova, Godina “Sky Tower”, Kt.3, Zyra Nr.6 Tiranë, Shqipëri.**
- 2.3 Shoqëria, me vendim të organit administrativ mund të hapë ose të mbyllë degë dhe zyra të tjera të saj në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë apo jashtë saj.

NENI 3 - KOHËZGJATJA

- 3.1 Shoqëria themelohet për të kryer aktivitetin e saj në përputhje me legjislacionin e Republikës së Shqipërisë, për një periudhë kohore me afat 20 (njëzet) vjeçar, duke filluar që nga regjistrimi i saj në Regjistrin Tregtar, pranë Qendrës Kombëtare të Bisnesit.

**KREU II
OBJEKTI**

NENI 4 - OBJEKTI

- 4.1 Në përputhje me statutin dhe liçensat që do të përfitojë nga autoritetet përgjegjës shoqëria do të kryejë veprimtari në fushat si me poshtë:



Rikonstruksion dhe ndërtim i veprave civile si: ambiente tregtare dhe magazinimi, hotele, bar-restorante, ambiente të jashtme dhe të brëndshme banimi dhe zyresh dhe industriale si: stacione treni, nënstacione elektrike/hidraulike, shtëpi sociale etj. Konsulencë dhe përgatitje të projekteve mbi masat e mbrojtjes nga zjarri, përmbytjet dhe fatkeqësive natyrore të ndërtesave të çdo lloji, asistencë ekonomike dhe teknike të projekteve, në fushën e ndërtimit publik dhe privat. Shitje dhe Blerje materiale elektrike, hidraulike, ndërtimi, kondicionimi, bujqësore etj. Shitje dhe Blerje të pasuri të paluajtshme, dhënie, marrje me qira dhe shitje pronash, menaxhim dhe administrim pronash etj. Kryerjen e çdo lloj aktiviteti që bën pjesë në objektin e saj, që lidhet me të dhe që e mbeshtet atë.

KREU III KAPITALI – KUOTAT – TRANSFERIMI I KUOTAVE

NENI 5 – KAPITALI DHE ORTAKU/ËT

- 5.1 Kapitali themeltar i shoqërisë është 1,000 (njëmijë) lekë, i përbërë nga 1 (një) kuotë e Përgjithshme.
- 5.2 Ortaku i Vetëm themelues z.Dritan Ndoj është zotërues i 1 kuote, me vlerë të përgjithshme 1,000 (njëmijë) lekë, që përbën 100 % (njëqind përqind) të kapitalit të shoqërisë.
- 5.3 Ortaku me vendim asambjeje të ortakut të vetëm ka të drejtë ta tjetërsojë këtë kapital, të shtojë apo të pakësojë kuotën e kapitalit deri në kufijtë minimal të përcaktuar nga ligji.
- 5.4 Kontributi i Ortakut mund të jetë në para apo në natyrë (pasuri të luajtshme, paluajtshme ose të drejta).
- 5.5 Ortaku ka pavarësi ligjore, organizative si dhe të drejta pronësie mbi çdo lloj kapitali, fitimi netto të deklaruar mbi qarkullimin si dhe mbi çdo lloj pasurie tjetër të shoqërisë të fituar në rrugë të ligjshme. Shoqëria përgjigjet vetëm me kapitalin e saj.

KREU IV ORGANET E SHOQERISË

NENI 6 - ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME

- 6.1 Asambleja e përgjithshme e përbërë nga ortaku i vetëm, është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:
 - a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
 - b) ndryshimin e statutit;
 - c) emërimin dhe shkarkimin e administratoreve;
 - d) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
 - e) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "ç" të kësaj pike;
 - f) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e Pasqyrave Financiare Vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
 - g) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
 - h) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
 - i) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
 - j) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
 - k) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
 - l) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
 - m) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.



- 6.2 Asambleja e Përgjithshme merr vendime për çështjet e përcaktuara në shkronjat "e" dhe "ë" të pikës 1 të këtij neni, pas marrjes dhe shqyrtimit të dokumenteve përkatës.
- 6.3 Të drejtat dhe detyrimet e Asamblesë së Përgjithshme ushtrohen nga ortaku i vetëm. Të gjitha vendimet e marra nga ortaku i vetëm regjistrohen në një regjistër të vendimeve, të dhënat e të cilit nuk mund të ndryshohen ose të fshihen.
- 6.4 Duhet regjistruar në veçanti, por pa u kufizuar në to, vendimet për:
- miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecuresë së veprimtarisë;
 - shpërndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve;
 - investime në pasuri të luajtëshme/ të paluajtëshme;
 - vendimet për riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.
- 6.5 Vendimet e paregjistruara në regjistrin e vendimeve janë absolutisht të pavlefshme. Shoqëria nuk mund t'i kundrejtojë pavlefshmërinë të tretit, që ka fituar të drejta në mirëbesim, përveç rastit kur shoqëria provon se i treti ka pasur dijeni për pavlefshmërinë, apo në bazë të rrethanave të qarta nuk mund të mos kishte pasur dijeni për të.

NENI 7 - MBLEDHJA E ASAMBLESE SË PËRGJITHSHME

- 7.1 Asambleja e përgjithshme e përbërë nga ortaku i vetëm, është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:
- 7.2 Asambleja e përgjithshme do të mbledhet në rastet e përcaktuara nga ligji, si dhe nga ligje të tjera apo nga dispozitat e statutit dhe sa herë që mbledhja është e nevojshme për të mbrojtur interesat e Shoqërisë. Mbledhja e zakonshme e asamblesë së përgjithshme thirret të paktën një herë në vit.
- 7.3 Asambleja e përgjithshme thirret nga administrator/ët apo ortaku/ortakët e përcaktuar sipas nenit 84 të këtij ligji.
- 7.4 Asambleja e përgjithshme thirret nëse, sipas Bilancit Vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë, nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim.
- 7.5 Asambleja e përgjithshme thirret kur shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjetër aktive, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5% (pesë përqind) të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të çertifikuara pranë Drejtorisë së Përgjithëshme/Rajonale Tatimore.
- 7.6 Asambleja e përgjithshme thirret kur shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 (pesë përqind) të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të çertifikuara.
- 7.7 Në rastet e parashikuara në nenin 8 të këtij statuti, asambleja e përgjithshme mund të miratojë një rezolutë këshilluese, duke miratuar apo bërë vërejtje për veprimtarinë e administratorëve.
- 7.8 Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose, nëse parashikohet nga statuti, me njoftim nëpërmjet postës elektronike (*info@dnprojects.net*). Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 10 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.
- 7.9 Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur sipas pikës 7.8 të këtij neni, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse ortaku apo ortakët janë dakord, për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.



NENI 8 – ADMINISTRIMI I SHOQËRISË

8.1 Shoqëria, do të administrohet nga administratori:

z.Dritan Ndoj, shtetas shqiptar lindur më 22-04-1980, në Pukë dhe banues në Tiranë në Rrugën “Siri Kodra”, madhor dhe me zotësi të plotë për të vepruar mbajtës i letërnjoftimit (ID) me Nr.032754871 dhe Nr.Personal I00422060L, me afat 5 (pesë) vjet emërimi, me të drejtë ripërtëritjeje.

8.2 Administratori, ka të drejtë dhe detyrohet të:

- a) kryej të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
- b) përfaqësoj shoqërinë tregtare, ndaj paleve të treta;
- c) kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- d) përgatisë dhe nënshkruajë Pasqyrat Financiare vjetore, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, dhe të paraqesë këto dokumente përpara Asamblesë së Përgjithshme për miratim;
- e) krijojë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- f) kryejë regjistrimet dhe dërgojë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në Aktet Ligjore/Udhëzimet e “Qendrës Kombëtare të Bisensit” dhe Aktet Ligjore/Udhëzimet e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve;
- g) raportojë përpara Asamblesë së Përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
- h) punësojë shtetas të ndryshëm, madhor me zotësi për të vepruar, duke lidhur kontratë pune sipas kriterëve të përcaktuara në Kodin e Punës dhe në zbatim të Ligjit Nr.7703 datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore”, të ndryshuar si dhe në zbatim të rregullave të brendshme të shoqërisë për funksionimin e disiplinës në punë; kryejë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.

8.3 Këshilli i administrimit (*Asambledhja e Përgjithshme*), mund t'i shkarkojë administratorin në çdo kohë. Padi të, që lidhen me shpërbllimin e anëtarit, në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi. Statuti apo marrëveshje të tjera nuk mund të përjashtojnë apo kufizojnë këtë të drejtë.

8.4 Administrator i shoqërisë mund të përfaqësohet nga persona të tretë të besuar prej tij, gjithmonë brenda kufijve ligjor dhe me autorizim të posaçëm, të lëshuar sipas ligjit.

8.5 Nëse administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkelin standardet profesionale, është i detyruar t'i dëmshpërblej shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojnë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta.

8.6 Administratori ka barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tij në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kërkuara. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator, ai përgjigjet ndaj shoqërisë në mënyrë solidare.



KREU IV
PRISHJA - NDARJA-BASHKIMI-LIKUIDIMI

NENI 9 - SHKAQET E PRISHJES SË SHOQËRISË

- 9.1 Shpërndarja ose prishja e shoqërisë mund të bëhet në çdo kohë dhe për çfarëdolloj shkak, edhe para përfundimit të afatit për të cilën është krijuar, siç mund të jenë:
- a) humbja e kapitalit ose pamundësia e vazhdimit të mëtejshëm të veprimtarisë së saj;
 - b) një nga pikat e parashikuara nga ligji "Për familentimin e Shoqërive Tregtare";
 - c) me plotësimin e afatit të caktuar për ushtrimin e veprimtarisë tregtare;
 - d) për arsye të tjera, të parashikuara në statut por të parashikuara në dispozitat e ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 "Per tregtarët dhe shoqëritë tregtare", të ndryshuar.

NENI 10 - LIKUJDIMI NË GJENDJEN E AFTËSISË PAGUESE

- 10.1 Me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi, prishja e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese, sipas neneve 190 deri në 205 të këtij Ligjit Nr.9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë Tregtare", të ndryshuar.

NENI 11 - LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM

- 11.1 Shoqëria "DN PROJECTS" sh.p.k, do të zhvilloj aktivitetin e saj në përputhje të plotë me këtë statut dhe dispozitat e legjisllacioneve në fuqi, të Republikës së Shqipërisë.
- 11.2 Përsa nuk parashikohet në këtë statut, do të zbatohen kryesisht dispozitat e ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 "Per tregtarët dhe shoqëritë tregtare", të ndryshuar, Kodit Civil dhe Administrativ si dhe çdo Ligji specifik, të Republikës se Shqipërisë.

ORTAKU I VETËM I SHOQËRISË
ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR "DN PROJECTS"

z.Dritan NDOJ

